

KONFERENCA

Shtrirja e strukturave komunitare në Shqipëri: Ndërtimi i axhendës për ndryshim

**Rogner Hotel Tirana (Salla Antigonea 2)
16 Maj 2017, Ora: 10.00**

Ky event shënon përfundimin e projektit "Tirana Flet / Shqipëria Flet", i zbatuar përgjatë periudhës Maj 2016-Maj 2017. Konferenca fokusohet në punën e bërë në kuadër të këtij projekti si dhe ofron një panoramë të plotë të sfidave në zbatimin e organizimit komunitar sipas Ligjit të ri për Vetë-Qeverisjen Vendore (nenet 68 dhe 69).

Gjatë kësaj periudhe përpjekjet tona synuan në prezantimin e implikimeve të Ligjit aktorëve publikë dhe jopublikë si dhe në ofrimin e mbështetjes për nismat lokale për të zbatuar këtë praktikë.

Rrjedhimisht, në bashkitë e Tiranës, Lezhës, Korçës, Kamzës, Durrësit, Beratit, Kukësit, Elbasanit, Fierit dhe Shkodrës u shprehën nivele të ndryshme interesi nga aktorët e përfshirë që kaluan nga "skepticismi", "vlerësimi" për qasjen në "iniciativa konkrete zbatimi".

Këshilli i Bashkisë Berat shënon njësinë e parë të qeverisjes vendore që ka miratuar kuadrin e nevojshëm rregullator dhe ka filluar të ngrejë strukturat komunitare. Por, ky është një proces i gjatë që ka nevojë për vizion, gadishmëri dhe kapacitete nga autoritetet, shoqëria civile dhe donatorët.

Me qëllim për të nxitur diskutimin rreth sfidave përpara, IDM do të ndajë me të gjithë të ftuarit në këtë event, të tillë si zyrtarët lokal dhe qendror, komuniteti i donatorëve, OSHC-të, akademikë dhe të tjerë aktorë të interesuar, një Dokument Politikash që mund të orientojë prezantimet dhe diskutimet në Konferencë. Gjithashtu, ky Dokument mund të shërbejë për veprime të ardhshme me qëllim adresimin e risqeve dhe sfidave me të cilat aktorët mund të përballen drejt një mjedisi mundësues për një model funksional të strukturave komunitare.



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



10.00

Mirëseardhja dhe Fjala e Hapjes

Fjala e Hapjes

Sotiraq Hroni, Drejtor Ekzekutiv, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë

Sh.T. Z. Cristoph Graf, Ambasador i Zvicrës në Shqipëri

Valbona Kuko, Drejtore Ekzekutive, Programi LëvizAlbania

10.30

Organizimi Komunitar – një alternativë ndryshe e qeverisjes

Vështrimi i përgjithshëm i aktiviteteve dhe qasjes së vet-organizimit komunitar - Evelina Azizaj,
Shefqet Bruka – Ekipi i projektit, IDM Përvoja e fituar në strukturat komunitare - Teuta
Muçogllava, Nënkrjetare, Bashkia Berat

10.45

Hapësirë për pyetje dhe diskutime

(Zyrtarët e lartë të qeverisjes vendore, këshilltarët, përfaqësuesit e OSHC-ve dhe liderët e komunitetit nga bashkitë e Kukësit, Lezhës, Korçës, Fierit, Tiranës, Kamzës, Elbasanit, Durrësit, Shkodrës ftohen që shkurtimisht (max. 2-3 minuta) të ndajnë perspektivat e tyre lokale rreth të njëjtës qasje të propozuar për strukturat komunitare.)

12.20

Përfundime – Ekipi IDM

12.30

Bufe